

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

31 Korrik, 2020

Të Dashur Prindër dhe Familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Më 30 Korrik, Bordi i Edukimit miratoi dy pika kryesore të veprimit - ndryshimet e propozuara të Drejtorisë në Planin e Rihapjes për Edukim të Sigurtë dhe Kalendarin Akademik 2020-2021.


Viti i ardhshëm shkollor do të fillojë të Mërkurën, 2 Shtator 2020, duke lejuar kohë shtesë që mësuesit të thellojnë aftësitë e tyre për t'u ofruar studentëve udhëzime angazhuese dixhitale. Të gjithë studentët K-12 do të angazhohen në mësimin dixhital pesë ditë në javë dhe do të marrin udhëzime nga mësuesit e shkollës së tyre gjatë periudhës së parë, e cila përfundon më 17 Nëntor 2020. Studentët do të kalojnë në një përzierje të të mësuarit personal dhe dixhital për sa kohë që udhëzimet nga Departamenti i Shëndetit Publik të Filadelfias dhe tregues të tjerë mbështesin se është e sigurtë për ta bërë këtë. Një opsion i mësimit dixhital 100% do të jetë i disponueshëm në atë kohë dhe ne do të vazhdojmë të shqyrtojmë mundësitë që nxënësit të mësohen nga mësuesit e shkollave të tyre. Studentët e Pre - K në programet Pre - K të Drejtorisë gjithashtu do të marrin udhëzime dixhitale pesë ditë në javë gjatë periudhës së parë .

Kalendari Akademik 2020-2021 pasqyron 180 ditë mësimdhënie për studentët nga 2 Shtatori 2020 deri më 11 Qershor 2021. Ka 23 ditë festash(pushime) për studentët dhe mësuesit. Për të parë kalendarin, ju lutemi klikoni [këtu](#) ose vizitoni faqen tonë të internetit në www.philasd.org dhe klikoni në "calendar link" në krye të faqes.

Në javët e ardhshme ne do të ndajmë më shumë detaje në lidhje me aspektet kryesore të planifikimit tonë, duke përfshirë inisiativën tonë "*Healing Together*", nisma për të mbështetur nevojat social-emocionale të studentëve dhe personelit tonë; oraret e shkollës dhe oraret mësimore; shpërndarja dhe ndihma e Chromebook; hyrje në internet; shpërndarja e vaktit ushqimor për studentët; përmirësime të objekteve në shkolla dhe më shumë.

Faleminderit për angazhimin dhe partneritetin tuaj pasi ne avancojmë një plan të rihapjes që ofron mundësi arsimore që të gjithë studentët tanë kanë nevojë dhe meritojnë duke mbështetur shëndetin dhe mirëqënien e të gjithëve. Së bashku, ne mund të përgatitemi për një vit shkollor të sigurtë dhe të suksesshëm.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias